



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

Ndikimi i COVID-19 në punën e OShC-ve në Kosovë

Të gjeturat fillestare

Prishtinë, prill 2020

TË GJETURAT KRYESORE – OShC

Ndikimi i COVID-19 në punën dhe financat e OShC-ve

COVID-19 ka pasur ndikim në punën e gati se të gjitha OShC-ve (96.71%)

Shumica e OShC-ve punojnë në distancë (60%) dhe ose i kanë mbyllur zyret e tyre tërësisht (20%)

COVID-19 e rrezikon dukshëm vazhdimësinë e punës së organizatës (62.5%)

#Për shkak të pamundësisë për ta mbajtur stafin nëse situata e tillë vazhdon edhe për një kohë

#Për shkak të mungesës dhe anulimit të mundësive për aplikim për fonde

Largim të tërësishëm apo për një kohë të caktuar të stafit (30%) apo rënie të numrit të vullnetarëve (38%)

Iniciativat OShC-ve gjatë pandemisë COVID-19

Shumica e OShC-ve e kanë pezulluar aktivitetin e tyre të rregullt, por në të njëjtën kohë janë të gatshëm të angazhohen në iniciativa që kanë për qëllim luftimin e COVID-19 (81%)

Shumë OShC tashmë kanë ndërmarrë aktivitete si përgjigje ndaj situatës me COVID-19

#Masa parandaluese të sigurisë për stafin e tyre

#Fushata vetëdijësimi "Rri në shtëpi" dhe "Distancim Social"

Shpërndarja e kutive bazike të higjienës për grupet e marginalizuara

#Përkrahje të komunave në identifikimin dhe shpërndarjen e pakove ushqimore për personat në nevojë

Ofrim të shërbimeve këshilluese online

#Monitorim të vendimeve të Qeverisë për COVID-19, përfshirë vendimet për mbështetje financiare, lirinë e lëvizjes, të drejtat e njeriut, lirinë e asociimit etj.

Monitorim të portaleve online dhe meidieve tjera për raportim të drejtë rreth pandemisë COVID-19

OShC-të dhe Qeveria

Në përgjithësi, OShC-të janë të kënaqur me qartësinë dhe komunikimin e vendimeve të Qeverisë për COVID-19 (42% të kënaqur, 42% deri diku të kënaqur)

Një e treta e OShC-ve do të aplikojnë për ndihmë financiare në kuadër të Pakos Emergjente Fiskale të Qeverisë (32%)

HYRJE DHE DEMOGRAFIA

Përmbledhje fillestare e ndikimit të COVID-19 në punën e OShC-ve në Kosovë.

Gjatë pjesës së dytë të muajit Prill:

Anketë online me OShC (152 respondentë)

Intervista me organizata donatore

Intervista me institucione publike

Në vazhdim: (Prill-Maj):

Konsultime shitesë me organizata donatore dhe institucione publike

Fokus grupe me OShC

Raporti i plotë i hulumtimit

TË GJETURAT KRYESORE – Organizatat donatore

Rritje e fleksibilitetit në modalitetet e zbatimit të projekteve nga shumica e donatorëve

Shumica e donatorëve janë treguar fleksibil sa i përket afateve të raportim të gratistëve të tyre, përfshirë këtu ofrimin e mundësisë për zgjatje të afatit pa kosto shtesë (no-cost extension)

Organizatave të sapo kontraktuara j'u është kërkuar që të bëjnë përshtatjen e aktiviteteve të projekteve tyre dhe të vazhdojnë zbatimin e tyre online me aq sa është e mundur

Shumë mundësi financimi për OShC-të u ndaluan ose u shtynë nga donatorët për një afat të pacaktuar

Nuk është raportuar asnjë ndërprerje e kontratës nga donatorët si rrjedhojë e situatës me COVID-19

Disa organizata donatore i kanë përshtatur praktikat e tyre të punës për të siguruar mbështetje shtesë për OShC-të që të angazhohen në lehtësimin e situatës së krijuar nga COVID-19

SFIDAT KRYESORE

Qëndrueshmëria e OShC-ve e rrezikuar në fazën e pas emergjencës së krijuar nga COVID-19 (pas 3-6 muajsh)

Nevojë urgjente për të ri-planifikuar punën e tyre për të qenë relevant për qytetarët dhe grupet për të cilët punojnë

Mungesë e granteve fleksibile dhe operative për OShC-të që do të mundësonte përshtatje graduale në ndryshimet e rrethanave si pasojë e COVID-19

Anulimi apo shtyerja e mundësive për aplikim për fonde kanë ndikuar seriozisht në punën e shumë OShC-ve

OShC-të që ofrojnë shërbime kanë përjetuar pothuajse një mungesë të plotë të të ardhurave

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme nga OShC-të dhe grupet e tyre të synuara (veçanërisht grupet e marginalizuara) ka vështirësuar dhe pamundësuar punën në distancë/online

Mungesa e fondeve ka pamundësuar ofrimin e shërbimeve nga OShC-të për grupet e marginalizuara, përkundër rritjes së kërkesës për këto shërbime

Vështirësitë e OShC-ve për të punuar me grupet e tyre të synuara edhe pas COVID-19

Pamundësia e OShC-ve për të siguruar pajisje sanitare dhe higjienike për stafin e tyre për të vazhduar punën gjatë gjatë pandemisë COVID-19

Shumica e aktiviteteve/shërbimeve të OShC-ve për grupet e synuara kërkojnë prezencë fizike

VEPRIMET QË DUHET TË MERREN

COVID-19 do të jetë një betejë e gjatë dhe e vazhdueshme. Për ta fituar këtë betejë, angazhimi ndër të tjera duhet të fokusohet në punë me qytetarët dhe komunitetin në përgjithësi. OShC-të janë më të afërtat me komunitetin, veçanërisht me grupet e marginalizuara. Andaj, OShC-të duhet të jenë të përgatitën qysh tani për të qenë në gjendje t'i përgjigjen nevojave të shfaqura në fazën pas COVID-19.

Për ta mundësuar këtë, një sërë veprimesh të rëndësishme duhet të ndërmerren:

Qeveria duhet të konsiderojë përfshirjen e aktorëve kryesor të shoqërisë në betejën me pandeminë COVID-19

duke bashkuar OShC-të, bizneset, mediet, organizatat ndërkombëtare të donatorëve

Donatorët dhe Qeveria duhet të ofrojnë mbështetje fleksibile për shpenzimet operative të OShC-ve, për të mundësuar që OShC-të të mbijetojnë në fazën pas COVID-19 dhe të përshtasin programet e tyre për t'iu përgjigjur krizës dhe nevojave të rimëkëmbjes

përshtatjen e instrumentet për përkrahje financiare të OShC-ve nga donatorët

ndryshimi i qasjes për përkrahje të OShC-ve nga fondet publike, nga përkrahja ad-hoc e projekteve në mbështetje më fleksibile dhe për shpenzime operationale, brenda shumës së zakonshme të fondeve publike për OShC-të

Donatorët dhe qeveria duhet të vazhdojnë mbështetjen e tyre për shoqërinë civile duke u përshtatur me nevojat e reja, për të mundësuar aktivitetin dhe mbijetesën e OShC-ve

duke mos i anuluar apo shtyer mundësitë e financimit për OShC

Donatorët dhe Qeveria duhet të mbështesin ofrimin e shërbimeve publike nga OShC-të

të rritet mbështetja për aktivitete sociale, shëndetësore, dhe aktivitete tjera për përfitim të publikut që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve për qytetarët në përgjithësi, dhe për grupet e marginalizuara në veçanti

Qeveria duhet të respektojë të drejtat e njeriut edhe gjatë ballafaqimit për të shpëtuar jetë në kohë pandemie

të sigurojë që masat COVID-19 janë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë lirinë e asociimit dhe lirinë e tubimit

Qeveria duhet të sigurojë që OShC-të që i shërbejnë grupeve të marginalizuara dhe atyre që kanë më së shumti nevojë janë në fokusin e Pakos Emergjente Fiskale

Përkrahur nga:



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe jo patjetër i reflekton pikëpamjet e Sida.

Të drejtat e rezervuara © 2020. Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)